

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË**, Gjyqtari Qemail Suka me Sek. Juridike Vjollca Haziraj , në lëndën penale PP./II.nr. **PP.nr.3103/15 te dt. 12.05.2016**, ndaj te akuzuarit D. A. nga fsh. S. KK Suhareke, per shkak te vepres penale rrezikimi i trafikut p ublik nga neni 378 parg. 6 lidhur me parg. 1 te KP-se, duke vendosur sipas Aktakuzës të PTH në Prizren , në prezencën e PSH Besim Susuri dhe të akuzuarit, me daten 16.05.2018 morri dhe publikisht shpalli dhe me datë 29.05.2018 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I Akuzuari D. A., nga i ati Z., e ëma V., e lindur K., i lindur me dt. 19.01.1991 ne S., ku dhe tani jeton, me numër personal ....., i martuar, baba i dy fëmijeve, i pa pune, ka te kryer shkollën fillore, i gjendjës se dobët ekonomike, me pare i pa dënuar, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës**

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse me datën 02.10.2015 rreth orës 18:00, në Suharekë, në rrugën “B. 1..”, tek vendi i quajtur “H.”, nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë, si pjesmarrës në komunikacionin rrugor, duke drejtuar automjetin e markës “VW G.”, me targa te regjistrimit 04-...-AF, ngjyrë e kuqe, vepron në kundërshtim me nenin 126 te LSKRR-së, në atë menyrë që nuk mban distancën e mjaftueshme të sigurisë ndaj automjetit i cili levizte para tij në të njëjtin drejtim të lëvizjes, ku me pjesën e përparme të automjetit, godet në pjesën e pasme automjetin e markës “VW G.”, me targa të regjistrimit 04-...-EQ, të cilën e drejtonte në drejtimin e tij të lëvizjes i dëmtuari B. H., ku si pasojë, pos dëmeve materiale në automjete, lëndime të lehta trupore pëson: O. A. dhe atë: kontuzion dhe ënjtje në nen gjurin apo kërcirin e majtë

**Me këtë veprim, ka kryer veprën penale, rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragra. 6 lidhur me paraga. 1 te KP-së.**

Gjykata në kuptim të nenit 41, 43, 46, 51, 52, 73, 74, të KP-së, si dhe nenit 378 par.6, lidhur me par. 1 të KP-së, të akuzuarit i shqipton:

**DENIM ME KUSHT**

Duke i vertetuar denim me burgim prej 3 (tre) muajve, i cili denim nuk do te ekzkeutohet ne afatin e verifikimit prej nje viti nese i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale, pas plotefuqishmerise se ketij aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari qe ne emër te shpenzimeve te ekspertizës se komunikacionit te paguaj shumën prej 40.88 euro, në emër te ekspertizës mjeko-ligjore shumën prej 20 euro, kompenzimin e viktimave te krimit 30 euro, si dhe në emër te paushallit gjyqësor shumën prej 20 euro, te gjitha keto pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi

Te demtuarit, B. R. H. nga fsh. S. Komuna Suharekë, A. H. B. na fsh. S. Komuna Suhareke, dhe O. D. A. nga fsh. S. Komuna Suhareke, permes perfaqesuesit te tij ligjore, udhezohen qe kërkesen pasuroro-juridike, ta realizojne ne kontest te rregullt civil

## A r s y e t i m

PTH. nga Prizreni me aktakuzën **PP.nr. 3103/15 te dt. 12.05.2016**, ka akuzuar D. A. nga fsh. S. KK Suhareke , per veper penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paraga. 6 lidhur me paraga. 1 te KPK-së. Aktakuzën të cilën gjate seances gjyqësore prej fillimi e gjerë në mbarim e ka përfaqësuar PSH ne Prizren Besim Susuri i cila në tërsi ngel prane të dhënave si në aktakuzë që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata ne shqyrtimin e sotëm dhe me vet pranimin nga ana e te akuzuarit ka vërtetuar këtë gjendje faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vet pranimi i te akuzuarit i cili ne shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 257 te KPP-ës ne shkresat e lendes nuk ka gjetur ndonjë prove te pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë, pranimi i fajit nga ana e te akuzuarit, është bere vullnetarisht ne shqyrtimin fillestar, pranimi është mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban aktakuza, te cilat gjinden ne shkresat e lendes si dhe provat materiale te paraqitura ndaj te akuzuarit nga ana e PTH-ës ne Prizren.

Gjykata po ashtu ne tërësi ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë ne shqyrtimin fillestare nga ana e te akuzuarit, është bërë ne pajtim me dispozitat e nenit 248 te KPP-ës, nga se nuk ekziston ndonjë nga aresyet dhe kushtet për hudhjen e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale.

Nga këto fakte te cilat i përmbanë aktakuza, Gjykata ka ardhur ne përfundim se me veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paraga. 6 lidhur me paraga. 1 te KPK-së, andaj Gjykata ka vendosur te akuzuarin ta shpall fajtor dhe t'ia shqiptoi dënimin si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Gjykata gjate marrjes se vendimit mbi dënimin ka vlerësuar te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KP-ës, te cilat ndikojnë ne lartësinë e dënimin.

Gjykata si rrethane lehtësuese mori për baze se i akuzuari ka pasur qëndrim korrekt ndaj Gjykatës, ka bere pranimin e fajësisë ne mënyrë vullnetar, vepren penale nuk e ka kryer me dashje por nga pakujdesia.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike e mori ne kuptim te nenit 463 te KPP-ës .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës e mori ne kuptim te nenit 452 parag, 1 te KPP-ës.

### **GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKE**

**Gj y q t a r i**  
**Qemail Suka**

**KESHILLE JURIDIKE**: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtine, përmes kësaj Gjykate.